



Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik JUNIK sh.p.k NIPT J68007522L & HTS COMPANY sh.p.k NIPT M11619018P. Adresa: Lagjja SMT, Ndërtesë 2-Katëshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Lezhë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, me mjete elektronike – Punë.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Nr. REF 13525-07-18-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rehabilitimi i rrjetave metalike për 4 (katër) agregatët në veprën e marrjes së HEC Vau i Dejës dhe rehabilitimi i udhëzuesve të rrjetave në zonën nënujore me polumbarë për 5 (pesë) agregatë".

Kohëzgjatja e kontratës: 39 (tridhjetë e nëntë) muaj e ndarë :

Për realizimin e inspektimit dhe hartimin e projektit afati do të jetë 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Pas përfundimit të procesit të hartimit dhe pranimit të projekt-preventivit dhe projektit të zbatimit, kontraktori ka afat maksimal 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj për realizimin e punimeve përkatëse.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.40, datë 22/07/2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

✚ Bashkimi i Operatorëve Ekonomik JUNIK sh.p.k, NIPT J68007522L & HTS COMPANY sh.p.k, NIPT M11619018P, me vlerë të ofertës ekonomike 235,200,000 (Dyqind e tridhjetë e pesë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH.

✚ Operatori ekonomik MUHOPLUS LTD, NIPT L52317046G, me vlerë të ofertës ekonomike 238,582,000 (Dyqind e tridhjetë e tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik MUHOPLUS LTD, NIPT L52317046G, pasi :

- ✚ Nuk ka paraqitur sigurim oferte sipas shtojcës 3;
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.2.1, pasi vlerat e xhirove vjetore të 3 viteve të fundit të paraqitura nëpërmjet vërtetimit për xhiro vjetore të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë nuk arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një nga vitet e paraqitura.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.2.2, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri;
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponueshmërinë e pikës së licensës në fushën e projektimit në kategorinë 5- f;
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.3, në të cilin kërkohet: *Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024 1 (një) inxhinier ndërtimi ose hidroteknik; 2 (dy) inxhinier mekanik; pasi në formularin e vetëdeklarimit është deklaruar stafi teknik 1 ing mekanik dhe 1 ing elektrik. Sa më sipër OE nuk disponon 1 ing mekanik dhe 1 ing ndërtimi ose hidroteknik.*
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.4, pasi në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar nëse disponon apo jo stafin e kërkuar në këtë kriter.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.5, pasi në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar nëse disponon apo jo stafin e kërkuar në këtë kriter.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.6, pasi në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar nëse disponon apo jo stafin e kërkuar në këtë kriter.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.7, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponueshmërinë e certifikatës së kërkuar SSH UNI EN ISO 9712.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.9, pasi nuk është paraqitur për vizitën në kantier, kërkesë e këtij kriteri.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.10, pasi pajisjet e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit nuk janë ato të kërkuar në këtë kriter.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik JUNIK sh.p.k NIPT J68007522L & HTS COMPANY sh.p.k NIPT M11619018P, adresa: Lagjja SMT, Ndërtesë 2-Katëshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Lezhë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 235,200,000 (Dyqind e tridhjetë e pesë milion e dyqind mijë) lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (Tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

Jo.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erald Elezi